

Transparenca dhe Pjesëmarrja në Veprimtaritë Legjislative INTEGRIMI NË BE

Buletin informativ Nr.6

tetor 2006

Deklaratë e Përbashkët e Kryetarëve të Delegacioneve Parlamenti European Kuvendi i Shqipërisë

Në përfundim të Takimit të 13-të Ndërparlamentar Parlamenti Evropian-Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, mbajtur në Strasburg më datat 25-26 tetor 2006, dy delegacionet:

Për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe situatën politike në Shqipëri
1. përshëndetën nënshkrimin më 12 korrik 2006 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Vendeve të tij Anëtare dhe Shqipërisë, që krijon një marrëdhënie kontraktuale të ngushtë dhe me rreze të gjerë veprimi dhe që do të jetë e dobishme për të përmirësuar stabilitetin politik, institucional dhe ekonomik në vend dhe për ta konfirmuar Shqipërinë si një demokraci pluraliste; vlerësuan se nënshkrimi i MSA-së është një arritje e rëndësishme dhe se zbatimi i saj do të jetë një sfidë e madhe për Shqipërinë; ftuan Vendet Anëtare të BE-së që të vazhdojnë pa vonesë me ratifikimin e saj; vërejtën me kënaqësi se Marrëveshja e Përkohshme do të hyjë tashmë në fuqi më datë 1 dhjetor 2006;

(vijon në faqen 2)

Vështrim i përgjithshëm mbi Raportin e Progresit të Komisionit European për Shqipërinë

Ditmir Bushati

Raporti i 8 Nëntorit 2006 i Komisionit Evropian është raporti i katërt i radhës qysh se Shqipëria u përfshi në procesin e Stabilizim Asociimit. Raportet vjetore shërbejnë si një instrument kontrolli dhe vlerësimi të përgjithshëm për realizimin e reformave dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit dhe konkretisht nga dokumenti i Partneritetit Evropian dhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit¹. Raporti i këtij viti ruan të njëjtën strukturë si raportet e viteve të mëparshme por duke përdorur një terminologji të re, bazuar në stadin e zhvillimeve në të cilat ndodhet Shqipëria². Le të kujtojmë këtu se Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe konsiderohet si një vend kandidat potencial për tu anëtarësuar në BE. Ndaj edhe raporti nuk përdor më termin zbatim i procesit të Stabilizim Asociimit, por plotësim i angazhimeve që rrjedhin nga kriteri politik, kriteri ekonomik i anëtarësimit, dhe kapacitet

(vijon në faqen 6)

Në këtë numër:

1. Deklaratë e Përbashkët e Kryetarëve të Delegacioneve Parlamenti European Kuvendi i Shqipërisë *faqe 1-3*
2. Rezolutë e Parlamentit European mbi përmbylljen e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit mes Komuniteteve Europiane dhe Shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë. *faqe 4-5*
3. Vështrim i përgjithshëm mbi Raportin e Progresit të Komisionit European për Shqipërinë *Ditmir Bushati faqe 6-7*
4. Nga Veprimtaria e Komisionit Parlamentar të Integritimit tetor 2006 *faqe 1, 8-9*
5. Zbatimi i posaçëm i vlerësimit të ndikimit në procesin e integritimit european dhe procesin e negociatave për praninë (Botim SIGMA nr.31, maj 2001) *faqe 10-14*
6. Programi i punimeve të Kuvendit për periudhën 6 nëntor - 28 dhjetor 2006. *faqe 15-16*

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN TETOR 2006

Komisioni Parlamentar për Integritimit European për muajin tetor ka patur aktivitete të ndryshme në lidhje me fushën e kompetencës së tij.

Këto veprimtari mund të ndahen në:

Veprimtaria legjislative

Gjatë muajit tetor, Komisioni i Integritimit ka shqyrtuar disa projektligje. Kryesisht projektligjet konsideronin ratifikimet nga Parlamenti shqiptar i disa marrëveshjeve ndërkombëtare, titujt e të cilëve vijojnë më poshtë:

1. Projektligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin shumëpalësh të Konventës "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave (CMR). *(vijon në faqen 8)*

Deklaratë e Përbashkët e Kryetarëve të Delegacioneve

Parlamenti Europian /Kuvendi i Shqipërisë

(vijon nga faqja 1)

2. vlerësuan pozitivisht Planin Kombëtar të Veprimit për Zbatimin e MSA-së miratuar nga Qeveria shqiptare në muajin korrik 2006 dhe shprehën dëshirën për zbatimin e saj në kohë; vunë në dukje se, me qëllim që institucionet shqiptare të përqendrohen në mënyrë më të efektshme te reformat e nevojshme dhe te legjislacioni që lidhet me integrimin evropian dhe kapacitetet administrative, dialogu politik duhet të zhvillohet në një atmosferë më pak konfrontuese; risollën në vëmendje, në fakt, se zbatimi si duhet i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është baza më e mirë mbi të cilën duhet bërë vlerësimi i gatishmërisë së një vendi për të kaluar në fazën vijuese të statusit të kandidatit dhe, më pas, në negociatat për pranimin në BE;

3. shprehën shqetësim për moszbatimin në kohë nga ana e institucioneve shqiptare dhe partive politike të reformës zgjedhore dhe, në mënyrë të posaçme, të rekomandimeve që OSBE-ODIHR bërë pas zgjedhjeve parlamentare në muajin korrik 2005, sidomos të atyre që lidhen me regjistrin dhe identifikimin e votuesve, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me saktësinë e regjistrave të gjendjes civile, duke përsëritur domosdoshmërinë e dokumenteve të sigurta të identifikimit; u rekomanduan autoriteteve shqiptare dhe partive politike ta zbatojnë reformën zgjedhore deri në muajin nëntor 2006, në mënyrë të veçantë për të caktuar datën e zgjedhjeve vendore;

4. shprehën mendimin se nevojitet një reformë e mëtejshme e sistemit zgjedhor, sidomos për të garantuar një përfaqësim të drejtë në Parlament të forcave politike që mbështeten nga qytetarët shqiptarë, për të parandaluar praktikën ekzistuese të votimit taktik dhe për të krijuar sistemin e adresave të godinave, për të rritur saktësinë e listave të votuese;

5. shprehën shqetësim për përkeqësimin serioz të marrëdhënieve politike mes parlamentarëve të mazhorancës së djathtë dhe atyre të opozitës së majtë, që ka ndodhur gjatë debateve në lidhje me pavarësinë e institucioneve më të rëndësishme shqiptare, për procedurat parlamentare dhe për reformën zgjedhore; vlerësuan kompromisin pozitiv politik që u arrit në verë 2006 për Komisionin Qendror Zgjedhor dhe ligjin për mediat; shprehën dëshirën që këto të kthehen sa më parë në akte ligjore pa shtryrjen e mëtejshme të zgjedhjeve vendore;

6. theksuan se një marrëveshje apo kompromis me ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtar sigurisht nuk e zëvendëson debatin e civilizuar të brendshëm për reformën zgjedhore që nevojitet në Shqipëri; rekomanduan forcat politike, brenda dhe jashtë Parlamentit, të veprojnë në mënyrë konstruktive që secila të kontribuojë për përgatitjen e një reforme të përshtatshme dhe me konsensus të gjerë; shprehën dëshirën që në zgjedhjet e ardhshme vendore të dëshmohet një atmosferë më pozitive;

Për reformën në sistemin e drejtësisë dhe në administratën publike

7. vërejtën me keqardhje se niveli i korrupsionit në sistemin gjyqsor është ende i lartë; pranuan se Qeveria shqiptare ka bërë përparim në drejtim të reformës në sistemin e drejtësisë, duke përgatitur një projektligj për të përmirësuar transparencën e procedurave të një sistemi të shpërndarjes së rastësishme të çështjeve dhe të shkallës së zbatimit të vendimeve; duke ftuar autoritetet e interesuara që të rrisin përpjekjet e tyre në këtë rrugë, përsëritën edhe një herë se, megjithatë, përgjithësisht Shqipërisë i duhet të përmirësojë funksionimin dhe efektshmërinë e gjyqsorit;

8. vlerësuan se duhen bërë të gjitha përpjekjet për të rritur shkallën e pavarësisë së gjyqsorit, për të përmirësuar ligjin dhe shpërblimin e nëpunësve të gjyqsorit dhe stafit tjetër si dhe për të sqaruar kompetencat përkatëse të inspektoriateve ekzistuese;

9. duke pranuar se aparati i administratës publike shqiptare, ashtu si në vendet e tjera në tranzicion, mund të përfitojë nga një reformë, përfshirë reduktimin dhe rritjen e efektshmërisë së saj, shprehën dëshirën që shkarkimet dhe zëvendësimet që janë vërejtur në administratë, pas ardhjes në fuqi të Qeverisë së re, të mos shkelin Ligjin për Nëpunësin Civil, të mos diktohen nga një logjikë thjesht partiake, të mos dobësojnë profesionalizimin e konfirmuar dhe të mos rrezikojnë në plan afatmesëm kapacitetet administrative të Shqipërisë në lidhje me zbatimin e MSA-së; vlerësuan të rëndësishme që, për këtë qëllim, të forcohen burimet njerëzore pranë Ministrisë së Integritit; ftuan Qeverinë shqiptare të inkurajojë mundësi të barabarta dhe përfaqësim të drejtë të grave dhe të pakicave në strukturat e administratës publike;

10. duke pasur parasysh faktin që korrupsioni mbetet një problem serioz në Shqipëri, përsëritën politikën e "tolerancës zero", të shpallur nga Qeveria, dhe pranuan se disa masa serioze janë ndërmarrë, për shembull, për të reduktuar aparatën e Qeverisë, duke i kushtuar vëmendje më të madhe shpenzimit të parave publike, në fushën ekonomike dhe në reduktimin në njëfarë mase të rryshfeteve; ftuan autoritetet shqiptare të shtojnë përpjekjet për ta shndërruar këtë në një aksion të vazhdueshëm, asnjans, sistematik dhe të thellë kundër korrupsionit ku veprimtaritë e kontrollit financiar gjithashtu duhet të luajnë një rol të rëndësishëm;

11. për krimin e organizuar, vlerësuan pozitivisht vendosmërinë e Qeverisë për ta shkatërruar atë dhe, në mënyrë të veçantë, trafikimin e qenieve njerëzore dhe rrjetin e shpërndarjes së lëndëve narkotike, por këmbëngulën se Shqipëria duhet të tregojë përparim të mëtejshëm të dukshëm në luftën kundër të gjitha formave të krimit të organizuar, në mënyrë të veçantë, kundër trafikimit të grave dhe fëmijëve për qëllime shfrytëzimi seksual, pune apo lypjeje; rekomanduan që të vazhdohen përpjekjet për të krijuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e

(vijon në faqen 3)

Deklaratë e Përbashkët e Kryetarëve të Delegacioneve

Parlamenti European /Kuvendi i Shqipërisë

(vijon nga faqja 2)

dëshmitarëve; u bënë thirrje Vendeve Anëtare të BE-së dhe vendeve fqinje që, për këto çështje, të intensifikojnë bashkëpunimin në nivelin e policisë dhe gjyqsorit me Shqipërinë dhe Komisionin, në këtë kuadër, të vazhdojë të rrisë mbështetjen e fuqishme ndaj autoriteteve shqiptare; ftuan autoritetet shqiptare që të shqyrtojnë, mes të tjerash, përfundimin e mëtejshëm të njësive të informacionit financiar;

Për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave
12. risollën në vëmendje angazhimet e rëndësishme të Shqipërisë në fushën e të drejtave të njeriut, meqenëse Shqipëria është pjesë e Konventave më të rëndësishme ndërkombëtare për këtë çështje dhe fuqimisht ftuan autoritetet përkatëse që të bëjnë maksimumin që të sigurojnë procedim të drejtë gjyqsor dhe të shmangin që të mbizotërojnë *de facto* mosndëshkimi për pjesëtarë të efektivave të zbatimit të ligjit që përdorin forcë me tepri ose kryejnë akte torturash apo keqtrajtimesh; risollën në vëmendje se kushtet e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit janë të këqija dhe kërkuan që në legjislacion dhe praktikën administrative të përfshihen masat e duhura ligjore mbrojtëse në favor të personave të ndaluar nga policia; rekomanduan autoritetet kompetente që të propozojnë strategji të reja kundër dhunës ndaj grave dhe fëmijëve, përfshirë dhunën që ushtrohet në familje, dhe përshëndetën konsensusin e gjerë politik në Parlament për projektligjin kundër dhunës në familje; inkurajuan autoritetet kompetente që të vazhdojnë të hapin streha dhe qendra rehabilitimi për viktimat;

13. vërejtën me keqardhje se riintegrimi i viktimave të trafikimit akoma nuk trajtohet në mënyrë të kënaqshme në Shqipëri dhe inkurajuan Qeverinë dhe shoqërinë civile që të përqendrohen për të krijuar kapacitetet e profesionistëve dhe OJQ-ve të vijës së parë, sidomos për të trajtuar çështje të mbrojtjes së të miturve;

14. Me keqardhje vërejtën se në raportin e fundit vjetor të Reporterëve pa Kufi për Lirinë e Shtypit në Mbarë Botën, të vitit 2006, vlerësimi për Shqipërinë ka rënë; vlerësuan se liria dhe profesionalizmi i mediave duhet të përmirësohen dhe u kërkuan autoriteteve përkatëse, institucioneve dhe aktorëve shqiptarë që çështjet e interesave dhe burimeve të pronarëve të mediave, të kuadrit rregullues dhe të organit mbikëqyrës të mediave, t'i trajtojnë duke zbatuar legjislacionin përkatës në përputhje me standardet e BE-së;

15. i bënë thirrje Shqipërisë që të bëjë përpjekje të mëtejshme për të mbrojtur të drejtat e pakicave dhe për të plotësuar dhe zbatuar legjislacionin e saj që lidhet me pakicat në mënyrë që të mbështesë zbatimin e Konventave përkatëse ndërkombëtare që janë ratifikuar nga Shqipëria; vërejtën se duhen bërë përpjekje të mëtejshme, në mënyrë të veçantë, për sa i përket rritjes së përdorimit të gjuhëve të pakicave në marrëdhëniet e qytetarëve me autoritetet dhe vendosjes së emrave vendorë tradicionalë, duke rritur mundësinë e përdorimit të mediave nga ana e pjesëtarëve të grupeve të pakicave,

duke zgjeruar mundësitë për t'u arsimuar në gjuhën e pakicës dhe duke mbështetur shoqërinë civile; vlerësuan se, për të hartuar një politikë më të mirë në këtë fushë, do të nevojiteshin informacione të sakta statistikore për pakicat kombëtare;

Për situatën ekonomike në Shqipëri

16. përshëndetën zhvillimet pozitive makro-ekonomike dhe të ardhurat e qëndrueshme nga buxheti vjetor për vitin 2006; nënvizuan rëndësinë e një sistemi të sigurtë dhe të rinovuar energjistik, veçanërisht sa i takon furnizimit me energji elektrike, dhe inkurajuan autoritetet kompetente shqiptare që të përmirësojnë veprimtarinë e tyre për arkëtimin e faturave të energjisë elektrike dhe për pakësimin e humbjeve të energjisë elektrike; sollën në vëmendje se, në dritën e zbatimit të MSA-së, është me rëndësi thelbësore që Shqipëria të bëhet me konkurrese, për shembull, në sektorin bujqësor, në mënyrë të veçantë, për të arritur standarde më të mira dhe për certifikimin e produkteve, për të qenë e aftë të përmirësojë eksportet dhe financat publike përballë heqjes graduale të pengesave dhe tarifave tregtare;

17. rekomanduan që Shqipëria të fokusohet më shumë në zhvillimin e potencialit të saj ekonomik përmes përmirësimit dhe zgjerimit të infrastrukturës së transportit në mbrojtje më të mirë të mjedisit dhe zhvillimin e një infrastrukture turistike dhe mjedisore më të qëndrueshme;

18. në përputhje me dëshirën e Parlamentit Evropian dhe nismën e Komisionit Evropian, si dhe duke pasur parasysh nënshkrimin e marrëveshjes së ripranimit mes Shqipërisë dhe BE-së, kërkuan nga Vendet Anëtare të BE-së dhe, në mënyrë të veçantë, nga Presidenca Finlandeze e Radhës që të bien dakort me shpejtësi për lehtësimin e procesit të lëshimit të vizave për qytetarët shqiptarë, të cilët dëshirojnë të udhëtojnë në Vende të BE-së për qëllime të ligjshme, sidomos për të studjuar apo për të punuar;

19. shprehën shqetësim se ekonomia informale shqiptare mbetet një konkurrues i pandershëm në treg dhe se mjedisi i biznesit nuk është aq tërheqës për investime sa ç'mund të ishte, kryesisht për shkak të infrastrukturës së dobët, mangësive në legjislacion dhe zbatimin të dobët të ligjeve në përgjithësi, dhe legjislacionit për taksat në veçanti; u bënë thirrje aktorëve përkatës që të fitojnë kohën e humbur për privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha dhe të lehtësojnë bashkëpunimin mes sektorit privat dhe publik në ekonomi;

Për rolin e Shqipërisë në rajon

20. në këtë periudhë veçanërisht delikate, kur janë marrë ose do të merren vendime të rëndësishme, vlerësuan rolin moderator të Shqipërisë në rajonin e Evropës Juglindore dhe u bënë thirrje Qeverisë dhe institucioneve të ecin në të njëjtën linjë me politikat rigorozë dhe të punojnë për dialogun dhe zgjidhjen konsensuale të çështjeve madhore, kjo edhe në kuadrin e nismave të ndryshme shumëpalëshe; risollën në vëmendje se dialogu dhe bashkëpunimi rajonal janë gjithashtu, pjesë e rëndësishme e Procesit të Stabilizim- Asociimit

Rezolutë e Parlamentit Evropian mbi përmbylljen e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit mes Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë.

Parlamenti Evropian,

- *duke marrë në konsideratë* Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) mes Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve të tyre anëtare në njërën anë dhe Republikës së Shqipërisë në anën tjetër (COM(2006)0138),

- *duke marrë në konsideratë* Raportin e Komisionit mbi Progresin e Shqipërisë në procesin e Stabilizim Asociimit, të datës 9 Nëntor 2005 (SEC(2005)1421)

- *duke marrë në konsideratë* Dokumentin e Komisionit mbi Strategjinë e Zgjerimit të datës 9 Nëntor 2005 (COM(2005)0561) dhe rezolutën e Parlamentit Evropian të datës 16 Mars 2006 mbi Dokumentin e vitit 2005 të Komisionit për strategjinë e zgjerimit ¹,

- *duke marrë në konsideratë* pozicionin e tij të datës 6 Shtator 2006 për këtë çështje,²

- *duke marrë në konsideratë* Nenin 103(2) të Rregullores së tij.

A. Në kohën që Shqipëria përmbush kushtet për të hyrë në MSA me Komunitetet Evropiane dhe shtetet e tyre anëtare,

B. Në kohën që MSA do të zëvendësojë Marrëveshjen e vitit 1992 për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Tregëtar,

C. Në kohën që përmbyllja e MSA me Shqipërinë i vendos marrëdhëniet e Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë në një bazë të re kontraktuale që siguron mundësi të reja për Shqipërinë në nixtjen e shtetit ligjor, forcimin e institucioneve demokratike, kontributit për stabilitetin, që përbën rëndësinë më të madhe për gjithë rajonin, si dhe forcimin e bashkëpunimit me Bashkimin Evropian,

D. Në kohën kur Këshilli Evropian i Selanikut i mbajtur më 19 dhe 20 Qershor 2003, ritheksoi vendosmërinë e tij për të mbështetur plotësisht dhe në mënyrë efektive perspektivën evropiane të shteteve të Ballkanit Perëndimor, që do të jetë pjesë integrale e Bashkimit Evropian sapo ata të përmbushin kriteret e caktuara,

E. Në kohën kur Shqipëria ende përballlet me sfida serioze në trajtimin e çështjes së korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke arritur zbatimin e plotë të legjislacionit të miratuar, duke përmirësuar administratën publike dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe drogave,

F. Në kohën kur zgjedhjet e fundit parlamentare në Shqipëri janë kritikuar si jo plotësisht në linjë me rekomandimet e OSBE/ODHIR dhe standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike,

1. Përhëndet MSA, e cila ofron visionin e një marrëdhënie kontraktuale të ngushtë e të gjerë mes Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë dhe që do të ndihmojë në arritjen e stabilitetit politik, ekonomik dhe institucional në vend e në të gjithë rajonin dhe promovimin e transformimit të Shqipërisë në një demokraci pluraliste që respekton shtetin ligjor, me një ekonomi tregu funksionale;

2. Beson se progresi në arritjen e standarteve të vendosura nga MSA duhet të monitorohen përmes afateve konkrete e të matshme nga ana e Këshillit të MSA dhe komisioni i përbashkët parlamentar përkatës;

3. Bën të ditura përfitimet afat-gjata që vijnë nga MSA si për popullin shqiptar ashtu edhe për BE-në. Vëren se avantazhet kryesore të MSA shtrihen në arritjen e qëllimit për një zonë të lirë tregtie dhe vendosjen e një angazhimi të qartë ligjor për bashkëpunim në fushat me

interes të përbashkët, si edhe promovimin e një mjedisi ligjor më të qëndrueshëm për investitorët;

4. Nxit BE-në dhe Shqipërinë ta përdorin MSA si një mundësi të përbashkët përfitimi, e për më tepër e këshillon Shqipërinë të shfrytëzojë mundësinë për të gjetur vendin e saj në tregun Evropian dhe të zhvillojë konkurrencën në sektorët e synuar;

5. Rekomandon që Shqipëria të fokusohet më shumë në zhvillimin e potencialit të saj ekonomik, përmes përmirësimit dhe mundësisht zgjerimit të infrastrukturës së saj të transportit dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm mjedisor e social; shpreh keqardhjen për shkurtimet e fundit në asistencën e jashtme në Kuadrin e Ndihmës Financiare; i bën thirrje Komisionit të caktojë fonde të mjaftueshme për përmirësimin e infrastrukturës së vendit, në veçanti për zhvillimin e transportit publik;

6. Konfirmon, në të njëjtën linjë me konkluzionet e Këshillit Evropian të Selanikut mbajtur më 19 dhe 20 Qershor 2003, mbështetjen e tij të plotë për perspektivën evropiane të Shqipërisë dhe integrimin e ardhshëm në familjen Evropiane; beson, megjithkëtë, se vokacioni i Shqipërisë ndaj vlerave Evropiane dhe standarteve të tyre është së pari dhe mbi të gjitha në të mirën e saj dhe duhet të ndiqet edhe si qëllim në vetvete;

7. Vë re se reformat e ndërmarra nga Shqipëria për të krijuar një shtet që bazohet në parimet e demokracisë, shtetit ligjor, ekonomisë së tregut të lirë, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe qeverisjes së mirë, thekson megjithatë faktin se Shqipëria ka nevojë t'i zgjerojë këto reforma dhe të tregojë rezultate më të prekshme në përputhje me dispozitat e vendosura për Partneritetin Evropian, si dhe të krijojë prova të qarta të zbatimit të suksesshëm të MSA-së, për të ecur drejt një faze të mëtejshme të integrimin Evropian; është veçanërisht i shqetësuar për mungesën e progresit domethënës në lidhje me zbatimin e plotë të ligjeve të miratuara; e konsideron thelbësore forcimin domethënës të kapaciteteve administrative, reformimin gjyqësorit dhe forcimin e parvarsisë së tij, për të mbrojtur të drejtat e grave, për të luftuar krimin e organizuar dhe për të promovuar lirinë e medias, ndërsa vetë mediat duhet të luftojnë për transparancën e tyre;

8. Vë re se qeveria është angazhuar në shkatërrimin e krimit të organizuar, përfshi këtu vendimin për ndalimin e gomoneve në luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe shpërndarjes së drogës, por insiston që Shqipëria duhet të tregojë progres të mëtejshëm domethënës në luftë kundër të gjitha formave të krimit të organizuar, në veçanti trafikut të grave dhe fëmijëve për qëllime të shfrytëzimit seksual, shfrytëzimit në punë apo detyrimin me forcë për të lypur, si një parakusht për bashkëpunim më intensiv me Bashkimin Evropian; i bën thirrje Komisionit Evropian të vazhdojë dhe forcojë mbështetjen për autoritetet shqiptare sa i takon kësaj çështjeje;

9. Vë re përpjekjet e qeverisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; vlerëson se korrupsioni është një nga pengesat kryesore për zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë dhe si pasojë pret që fushata e qeverisë të vazhdojë të tregojë rezultate të prekshme; është i mendimit se korrupsioni nuk ka ngjyrim politik dhe duhet të luftohet pavarësisht përkatësisë politike;

(vijon në faqen 5)

Rezolutë e Parlamentit Evropian mbi përmbylljen e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit mes Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë.

(vijon nga faqja 4)

10. Inkurajon organizmat e qeverisë Shqiptare të forcojnë shoqërinë civile duke i siguruar mundësi më të mëdha pjesëmarrjeje në formulimin e politikave dhe në monitorimin e zbatimit të tyre, si dhe efektshmërinë në të gjitha nivelet e qeverisjes, për të përmirësuar cilësinë dhe besueshmërinë e reformës, si dhe të rrisë transparencën dhe përgjegjshmërinë;

11. Vë re përpjekjet e ndërmarra nga Ministri i Arsimit për reformimin e sektorit të arsimit, por i këshillon qeverisë të garantojë mundësi arsimimi të barabarta për fëmijët në të gjithë vendin;

12. Thekson se ka ende shkelje domethënëse të të drejtave të njeriut në Shqipëri, të cilat duhen trajtuar; i këshillon qeverisë shqiptare të zbatojë reformat e nevojshme për t'i dhënë personave të ndaluar të drejtën e mbrojtjes në proceset ligjore dhe të luftojë torturën, brutalitetin apo trajtimin çnjerëzor apo degradues; i bën thirrje qeverisë të kryejë reformat përkatëse legjislative të kërkuara për zbatimin e Kodit të Familjes, të miratuar në vitin 2003, veçanërisht sa i takon shenjave të dhunës në familje dhe sulmeve kriminale;

13. Rithekson thirrjen e tij ndaj Komisionit Evropian për të ndihmuar Shqipërinë që t'i japë fund ekzistencës së fenomenit të gjakmarrjes, i cili përbën dështim të shtetit ligjor dhe është tërësisht në kundërshtim me vlerat Evropiane;

14. Vë re se sistemi aktual elektoral u përdor gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare të vitit 2005 për të shtrembëruar parimet e proporcionalit, të njohura gjithashtu si "fenomeni i dushkut", dhe e këshillon Qeverinë Shqiptare dhe Parlamentin ta reformojnë më tej sistemin zgjedhor para zgjedhjeve të ardhshme lokale duke ndjekur rekomandimet e formuluar nga OSBE-ODHIR, në veçanti sa i takon saktësisë së listave të zgjedhësve dhe regjistrat e gjendjeve civile;

15. I bën thirrje Shqipërisë të bëjë përpjekje të mëtejshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshi këtu të drejtat e minoritetit Grek në Shqipëri dhe për të përfunduar dhe zbatuar legjislacionin e saj përkatës mbi minoritetet, që ai të mbështesë zbatimin e konventave përkatëse ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria; vë re se nevojiten përpjekje të mëtejshme, në veçanti, sa i takon rritjes së përdorimit të gjuhëve të minoriteteve në çështjet që qytetarët duhet të zgjidhin me autoritetet dhe vendosjen e emrave tradicionalë lokalë, përmirësimit të aksesit në media për anëtarë të grupeve të minoriteteve dhe zgjerimit të arsimit në gjuhën e minoritetit përkatës; vë re mungesën e informacionit të duhur statistikor mbi minoritetet kombëtare;

16. Shpreh shqetësimin e tij për kërcënimet e fundit të opozitës për bojkotimin e zgjedhjeve të ardhshme lokale; i bën thirrje për këtë çështje të gjitha partive të vepronë në mënyrë të përgjegjshme, për të bërë të gjitha përpjekjet për arritjen e një marrëveshjeje mbi çështje delikate si ligji për mediat dhe lista e votuesve;

17. Përshëndet rolin konstruktiv dhe pozitiv që Shqipëria ka luajtur në iniciativat shumëpalëshe rajonale; nënvizon megjithatë domosdoshmërinë për të vazhduar promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë sa i takon çështjeve kyçe që prekin Evropën Juglindore, si bashkëpunimi ndërkufitar, lëvizja e lirë e njerëzve, lufta kundër krimit të organizuar dhe

trafiqeve, krijimi i zonave të tregëtisë së lirë, të afta për të tërhequr investimet e huaja, përdorimit të përbashkët të burimeve natyrore dhe zhvillimit të rrjeteve të integruara trans-kufitare;

18. Është i mendimit se, sa i takon zhvillimit të ulët ekonomik, Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë zhvillimit të bashkëpunimit ekonomik në rajon, në veçanti me fqinjët e saj të afërt; konsideron se pavarësia e Malit të Zi, negociatat mbi statusin e ardhshëm të Kosovës, si dhe hapja e bisedimeve për anëtarësimin në BE të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë në të ardhmen e afërt duhen parë si mundësi shtesë për bashkëpunimin ekonomik dhe zhvillimin e Shqipërisë dhe gjithë rajonit;

19. Është i mendimit se Shqipëria ka një rol veçanërisht të rëndësishëm për të luajtur në stabilitetin e rajonit të Evropës Juglindore, në veçanti sa i takon statusit final të Kosovës; e këshillon Qeverinë Shqiptare dhe udhëheqësit e saj të vazhdojnë të ndërmarrin qëndrime konstruktive në këtë kuadër;

20. Nënvizon rëndësinë e ndihmës së misioneve të BE-së për ngritjen e kapaciteteve dhe përshëndet rezultatet e arritura nga misioni i ndihmës për policinë shqiptare (PAMECA), misionit të asistencës për doganat shqiptare (EU-CAFAO) dhe misionit të ndihmës juridike (EURALIUS); duke marrë në konsideratë shtrirjen dhe kompleksitetin e luftës kundër krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor, i bën thirrje Komisionit Evropian të rrisë dhe forcojë asistencën e BE-së për policinë (PAMECA) dhe shtetit ligjor (EURALIUS); i bën thirrje BE-së dhe Shqipërisë në këtë kontekst të përfitojë nga programet e binjakëzimit dhe ato dytësore për përvojën dhe njohuritë e gjera të përfutuara nga vendet e reja anëtare të BE-së sa i takon reformimit të shoqërive dhe ekonomive të tyre në proceset integruese të BE-së, në veçanti sa i takon miratimit dhe zbatimit të ligjit për pronën dhe rikthimin e pronave, përfshi këtu pronësinë e komuniteteve fetare, si dhe forcimit të kufijve dhe autoriteteve doganore;

21. Përshëndet përfundimit e marrëveshjes së ripranimit me Shqipërinë në nëntor të vitit 2005 dhe bën thirrje për një marrëveshje të lehtësimit të vizave mes BE-së dhe Shqipërisë në kuadrin e lehtësimit të regjimit të vizave për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për të lehtësuar shkëmbimet ndërkufitare për komunitetin e biznesit, partnered sociale, përfaqësuesit e fushës akademike dhe studentore si hap i parë; thekson megjithatë, se objektivi përfundimtar duhet të jetë lehtësimi i udhëtimit për të gjithë qytetarët;

22. I rekomandon Presidentit të Parlamentit Evropian ta përcjellë këtë rezolute pranë Këshillit, Komisionit Evropian, si dhe Qeverisë dhe Parlamentit të Republikës së Shqipërisë.

¹ Texte të Miratuara. P6_TA (2006)0096

² Tekste të Miratuara. P6_TA-PROV(2006)0339

Vështrim i përgjithshëm mbi Raportin e Progresit të Komisionit Europian për Shqipërinë

(vijon nga faqja 1)

administrative të nevojshme për të realizuar përafrimin e legjislacionit në fushat kyçe të MSA-së dhe Dokumentit të Partneritetit Evropian.

Raporti analizon progresin e bërë nga Shqipëria në periudhën prej 1 tetorit 2005 deri më 30 shtator 2006, duke u mbështetur në informacionin e mbledhur nga vetë Komisioni, qëndrimet e Parlamentit Evropian, si edhe në kontributin e qeverisë shqiptare dhe organizmave ndërkombëtarë që asistojnë Shqipërinë. Para se të ndalemi në analizimin e disa fushave kryesore të përmbajtura në raport, është e rëndësishme të përmendim faktin se raporti përkon me një sërë momentesh të rëndësishme në të cilat ndodhet Shqipëria.

- *Së pari*, raporti del vetëm katër muaj pas nënshkrimit të MSA, duke shërbyer si matës real i kapaciteteve administrative në drejtim të përmbushjes së detyrimeve të MSA-së. Por jo vetëm kaq, çdo vlerësim do të ndikojë në hapat e mëtejshëm të procesit siç është ratifikimi i MSA nga vendet anëtare.

- *Së dyti*, Shqipëria ndodhet përpara zgjedhjeve vendore, të cilat më shumë sesa për nga rëndësia e tyre administrative, përsëri për fatin tonë të mirë apo të keq mbeten një test për demokracinë dhe përmbushjen e kriterit politik të Kopenhagenit.

- *Së treti*, kapacitetet zbatuese dhe reformat ekonomike ashtu sikurse dhe zgjedhjet do t'u nënshtrohen një testi të shpejtë që është pikërisht hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Përkohshme më 1 Dhjetor 2006. Për pasojë, raporti është një tregues real i mundësive tona për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Përkohshme.

Brenda pjesës së parë të raportit në atë që quhet vlerësimi i reformave në kuadër të kriterit politik analizohet roli i disa prej institucioneve më të rëndësishme si Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe sistemi i drejtësisë. Gjithashtu pjesë e kësaj analize janë edhe reformat e ndërmarra në mbrojtje të të drejtave të njeriut, luftës kundër korrupsionit si edhe respektimit të lirisë së mediave.

Pa dashur të bëjmë një trajtim dy ngjyrësh të arritjeve dhe kritikave të përmbajtura në raport është e rëndësishme të theksojmë që gjuha e raportit sjell në vëmendjen e të gjithëve rezultate konkrete të shënuara si edhe atë çka duhet përmirësuar duke ruajtur një strukturë dhe gjuhë konstruktive për të gjitha çështjet që evidentohen. Raporti analizon në mënyrë të përmbledhur veprimtarinë e Kuvendit, duke adresuar me të drejtë rolin e rëndësishëm që ky organ duhet të luajë në nxitjen e zbatimit të reformave të nevojshme. Megjithatë ajo që vërehet me shqetësim në këtë pikë është pikërisht një konsensus i brishtë politik parlamentar që shpesh ka çuar në situata ngërçi dhe në mungesën e miratimit të ligjeve të rëndësishme të cilat do të shënonin hapa konkrete ligjore në drejtim të reformës.

Procesi i reformimit nëpërmjet iniciativave të reja ligjore duhet parë i lidhur edhe me një problem tjetër të ngritur nga raporti, ai i hartimit të ligjeve, të cilat, në të shumtën e rasteve, hartohen nga një grup i mbyllur njerëzish duke sjellë si pasojë jo vetëm anashkalimin e

institucioneve përkatëse por edhe hartimin e teksteve të cilat nuk përputhen me standardet e kërkuara dhe shpesh të deklaruara antikushtetuese nga Gjykata Kushtetuese.

Raporti thekson se marrëdhëniet midis Kuvendit dhe organeve të tjera kushtetuese, vecanërisht Gjykatës Kushtetuese dhe Presidentit, si dhe ndërhyrjet pasuese të këtyre organeve, kanë qenë të duhura dhe efikase, duke legjitimuar rolin e këtyre aktorëve në procesin e forcimit të demokracisë shqiptare, por ë të njëjtën kohë duke I dhënë përgjigje edhe tezës së vjetëruar së supremacisë së parlamentarizmit. Në funksion të përmirësimit të jetës parlamentare, raporti bën thirrje për përmirësimin e procedurave të votimit të cilat do të mund të garantonin një rezultat transparent dhe të pakundërshtueshëm nga palët.

Duke qenë se një pjesë kryesore e punës për zbatimin dhe orientimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi integritetit realizohen nga administratat publike, raporti i kushton një vëmendje të posacmë asaj çka ka ndodhur realisht me kapacitetet administrative në Shqipëri. Raporti vlerëson se si pasojë e mungesës së respektimit të legjislacionit mbi shërbimin civil, në ristrukturimin e administratës publike, si pasojë e rotacionit politik të 3 korrikut 2005, kapacitetet administrative janë reduktuar, emërimt politike të nëpunësve të lartë vazhdojnë të jenë në masë, roli i Komisionit të Shërbimit Civil është minuar nga mos ekzekutimi i vendimeve të tij, duke e kufizuar ritjen e shërbimit civil në nivele profesionale. Në fakt, performanca e administratës publike mbetet një element i rëndësishëm për një zbatim të suksesshëm të Marrëveshjes së Përkohshme, por mbi të gjitha një premisë për të garantuar respektimin e kriterit të Madridit. Mos ekzekutimi i vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil sjell në të njëjtën kohë pasiguri ligjore dhe mungesë qëndrueshmërie në administratën publike. Efektiviteti dhe arritjet në luftën kundër korrupsionit maten mbi bazën e procedimave të kryera nga Prokuroria e Përgjithshme dhe vendimeve të dhëna nga sistemi gjyqësor shqiptar.

Për sa i përket reformave në drejtësi, raporti nuk adreson ndonjë problem të veçantë krahasuar me vitet e shkuara madje në disa raste vihen re përmirësime, si për shembull në rritjen e transparencës së vendimeve gjyqësore apo rritje të numrit të vendimeve të ekzekutuara. Megjithatë reformat në drejtësi janë thelbësore dhe nga raporti del qartë që sistemi gjyqësor është ende larg standardeve të nevojshme për të qenë një garant i zbatimit të drejtë të MSA-së. Raporti thekson se projekt ligji i ri i propozuar nga Këshilli i Ministrave për sistemin gjyqësor nuk adreson tri aspekte të rëndësishme: *rritjen e pavarësisë dhe mbrojtjen kushtetuese të gjyqtarëve, rritjen e pagave dhe statusit të stafit administrativ të sistemit gjyqësor dhe ndarjen e duhur të kompetencave midis inspektorateve të Këshilit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.*

(vijon në faqen 7)

Vështrim i përgjithshëm mbi Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë

(vijon nga faqja 6)

Plotësimi i standardeve evropiane për çështjet që kanë të bëjnë me liberalizimin e tregtisë dhe lëvizjen e lirë të mallrave shërbimeve dhe kapitalit janë një tjetër kapitull ku kurba e progresit luhet nga njëra çështje në tjetrën. Në raport janë evidentuar përpjekje serioze dhe rritje ekspertize në fusha të tilla si ndihma shtetërore dhe mbrojtja ndaj konsumatorit. Megjithatë për sa i takon kësaj fushe kërkohet një ndarje nga pikëpamja legislative për sa i takon mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorëve. Ndërkohë që mbeten problematike fusha të tilla si pronësia intelektuale dhe industriale, prokurimi publik, legjislacioni mbi shoqëritë tregtare, zbatimi i procedurave në dogana që kanë të bëjnë me rregullat e origjinës ku nuk raportohet progres. Në një pjesë të madhe të rasteve kërkohet përputhja e legjislacionit në këto fusha me *acquis communautaire*, pasi në shumicën e rasteve procesi i përafritimit nuk është nisur fare ose është duke u zhvilluar me ritme të ngadalshme.

Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Përkohshme Shqipëria është e detyruar të rishikojë klasifikimet doganore dhe një sërë rregullash të tjera të cilat duhet të lehtësojnë punën në dogana dhe si rrjedhojë një përfitim sa më të madh nga kjo marrëveshje. Bashkimi Evropian edhe sipas këtij raporti vazhdon të mbetet partneri kryesor në tregti pasi rreth 84 % e eksporteve nga Shqipëria kanë patur edhe këtë vit si destinacion BE-në.

Krijimi i një klime të favorshme për biznesin është realizuar me anë të disa iniciativave të reja që përmenden në raport siç është reduktimi i kohës së nevojshme për regjistrimin e një biznesi deri në 8 ditë, unifikimi i agjencive të cilat do të mundësojnë realizimin e *one stop shop*, përqendrimin të të gjitha procedurave në një institucion të vetëm. Megjithatë realisht mbetet shumë për të bërë në këtë drejtim, për sa i takon eliminimit të burokracive si edhe të futjes së elementeve të reja si regjistrimi *online* apo pranimi i parimit se *"heshtja është miratim"* në marrëdhëniet e biznesit.

Reformat në politikat sektoriale janë gjithashtu pjesë e kapitullit ku trajtohen standardet evropiane. Brenda këtyre politikave futen fusha të tilla si bujqësia, transporti, energjia, financat publike, statistikat, mjedisi, industria dhe SME-të si dhe politikat audiovizuale. Progresi në këto fusha mbetet i kufizuar dhe përkthehet kryesisht me përpjekje për të përafuar legjislacionin vendas me *acquis communautaire*. Sipas këtij raporti Shqipëria duhet të bëjë më shumë përpjekje në drejtim të rritjes së prodhimit dhe realizimit të këtij procesi në përputhje me standardet evropiane me qëllim që të kemi produkte konkurrense dhe të aftë për të përballuar tregjet evropiane.

Pjesa e fundit e raportit trajton reformat e ndërmarra në fushën e drejtësisë, sigurisë dhe lirisë. Një nga çështjet me të rëndësishme dhe shumë sensitive që trajtohet në këtë pjesë është ajo e vizave, e cila përqendrohet në masat që duhet të marrë Shqipëria në mënyrë që të përfitojë nga politikat lehtësuese të Brukselit. Në këtë kuadër vihen re disa arritje në administrimin e vizave,

në menaxhimin e kufijve nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve zbatuese si edhe nëpërmjet përmirësimit të logjistikës së nevojshme për një menaxhim më të mirë të kufijve. Puna e policisë së shtetit vlerësohet pozitivisht duke evidentuar rritjen e profesionalizmit dhe të bashkëpunimit të këtyre strukturave me struktura të tjera shtetërore të rëndësishme brenda dhe jashtë vendit.

Një çështje prioritare e parashikuar edhe në dokumentin e Partneritetit Evropian është lufta kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe trafikimit ku përsëri një pjesë e meritës shkon në drejtim të policisë së shtetit dhe organeve të drejtësisë për rezultatet e arritura. Vullneti politik vlerësohet si pozitiv në këtë drejtim pasi ai ndihmon në krijimin e një klime të favorshme në luftën kundër këtyre fenomeneve negative.

Megjithatë raporti thekson se një nga fushat e lidhura me çështjet e mësipërme që është mbrojtja e të dhënave personale mbetet shumë pak e zhvilluar në Shqipëri. Ndaj, nevojitet hartimi i kuadrit ligjor në përputhje me *acquis communautaire* si dhe ngritjen e strukturave përkatëse për mbrojtjen e të dhënave personale.

Më shumë se raporti në vetvete, do të jetë e rëndësishme puna që do të bëhet nga aktorët kryesorë, e kryesisht qeveria në adresimin e problematikës së trajtuar, me qëllim që të avancohet sa më shumë në procesin e integritetit evropian të vendit.

¹ Shih pikën 6 "Monitoring" të Vendimit të parë dhe të dytë të Këshillit të Bashkimit Evropian për Partneritetin Evropian me Shqipërinë, 2004/519/EC dhe 2006/54/EC, ku thuhet se : "Zbatimi i prioritetëve të PE-së matet me anë të mekanizmave të prezantuar në Procesin e Stabilizim Asociimit (PSA) siç është Raport Progresi Vjetor i Komisionit Evropian për secilin nga shtetet që aspiron të anëtarësohet në BE".

² Shih, Albania 2006 Progress Report, Brussels, 08.11.2006, SEC(2006) 1383, COM (2006), 649 final dhe Albania 2005 Progress Report, Brussels, 09.11.2005, SEC (2005) 1421, COM (2005) 561, final.

Ditmir Bushati

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN TETOR 2006

(vijon nga faqja 1)

2. Projektligji "Për ratifikimin e Protokollit për pranimin e Komunitetit Europian në Konventën Ndërkombëtare të Eurokontrollit, për bashkëpunimin për sigurinë e navigimit ajror, të 13 Dhjetorit 1960, të ndryshuar me anë të amendimit dhe të konsoliduar nga Protokollit i 27 Qershorit 1997"

3. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ushtarake grant, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë"

4. Projektligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes shumëpalëshe "Për ngritjen e një rrjeti hekurudhor, të përformacës së lartë, në Europën Lindore".

5. Projektligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të Sant Egidio-s, për Selinë dhe Veprimtarinë e këtij komuniteti në Shqipëri

1. Projektligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes "Plani i Veprimeve të Programit për Shqipërinë 2006 – 2010" ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (PNUD)"

Veprimtaria monitoruese

Komisioni Parlamentar për Integrimin Europian ka zhvilluar një takim me Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, Z. Genc Ruli i cili ka raportuar mbi çështjet e mëposhtme:

- Vizioni i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës për buxhetin e vitit 2006 lidhur me reformen e integritit që ka të bëjë me reformimin e institucioneve për strukturat në varësinë e kësaj Ministrie duke pasur parasysh rekomandimet e Dokumentit të Partneritetit.

Në mënyrë specifike

- Forcimi i kapaciteteve administrative të Sekretariatit me OBT-në dhe me Agjensinë e Promovimit të Eksporteve, Departamentin e Mbrojtjes së Konsumatorit, të Ndihmës Shtetërore, të Autoritetit të Konkurrencës dhe të Drejtorisë së Standarteve.

- Si dhe realizimi i paketës fiskale të re, të kërkesave ekonomike dhe Standarteve Europiane që jepen në raportin e fundit të BE-së dhe të Dokumentit të Partneritetit.

Në përgjigje të detyrimeve që rrjedhin nga MSA, sipas Ministrit Ruli, Qeveria ka miratuar planin kombëtar të veprimit. MSA-së I duhej një re-

formim në kuadrin strukturor. Duhet të krijimi i strukturave të reja të cilat më parë kanë qënë në varësi të Këshillit të Ministrave, si për shembull ristrukturimi i Agjencisë Kombëtare të Biznesit. Gjithashtu, po në kuadrin e reformimit ka patur edhe shkrirje strukturash. Sigurisht këto janë shoqëruar me ndryshime në personelin e administratës. Përsa i përket institucionit të Autoritetit të Konkurrencës është një institucion që varet nga Kuvendi dhe është i pavarur nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

Sipas Ministrit Ruli, është bërë një punë e madhe në përafrimin e legjislacionit me BE.

Është nënshkruar marrëveshja e tregtisë së lirë me Turqinë ndërkohë që është në proces nënshkrimi i një marrëveshjeje tjetër me Malin e Zi. Programi CARDS ka dhënë ndihmesë. Lidhur me marrëveshjet e tregtisë së lirë ka negociime me vende të ndryshme.

Në fushën e ndihmës shtetërore është dashur të bëjmë një punë njohëse për të kuptuar thelbin e këtij ligji. Për këtë qëllim është ngritur Komiteti i Ndihmës Shtetërore. Deri tani ka qënë funksional.

Në fushën e standartizimit po bëhen ndryshime në ligjin për standartizimin për të përafruar procedurat tona me ato të BE-së.

Mbrojtjes së konsumatorit I është dhënë rendësi. Shteti ka detyrim ligjor sigurinë. Çmimi vendoset nga privati por siguria është detyrim i shtetit. Gjithashtu Ministria ka një sërë projektsh me Bankën Botërore.

Veprimtari këshilluese në takime dypalëshe.

Komisioni për Integrimin Europian ka zhvilluar një takim me Z. Reinhard Priebe, Drejtor për Ballkanin Perendimor, Drejtorja e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Jashtë e Komisionit Europian. Komisioni i Integritit ka shprehur falenderimet për ndihmen që Z. Priebe i ka dhënë Shqipërisë në procesin e Integritit, si dhe për arritjen e për-bashkët në finalizimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

Kryetari i Komisionit u shpreh se forcat politike janë të angazhuara për të mbështetur këtë proces në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA. Gjithashtu forcat do të vazhdojnë të kenë një përqasje pozitive në rritjen e konsensusit mes palëve.

(vijon në faqen 9)

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN TETOR 2006

(vijon nga faqja 8)

Komisioni i integritetit, ndryshe nga panorama e debateve gjatë seancave plenare ka një konsensus të shprehur qartë në diskutimet e tij.

Në kuadër të kompetencave të Komisionit, ka një marrëdhënie të mirë edhe me Ministrinë e linjës, në vecanti me atë të Integritetit, lidhje e drejtpërdrejtë për sa i përket fushave të kompetencës, por edhe kryesisht me Ministrinë e Financave, atë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, dhe të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Megjithatë procesi i integritetit kërkon kohë.

Ndërsa Z. Priebe u shpreh se është e një rëndësie të vecantë që të forcohet besueshmëria e Shqipërisë në reformat, duke u nisur që nga dialogu parlamentar. E rëndësishme është që të mbahet një imazh i mirë i dialogut politik, i cili duhet të jëtë konstruktiv, dhe të mënjanohen incidentet dhe bojkotimet

Përsa i përket zgjedhjeve vendore, Priebe u shpreh se BE-ja nuk mund të japë një model të përcaktuar konsideruar shumëllojshmërinë e tyre në vende të ndryshme. Kjo do të thotë që Shqipëria duhet të gjejë vetë një model. Forcat politike duhet të bashkëpunojnë për zgjidhjen e kësaj çështje.

Zgjedhjet janë një çështje sistemi, janë një çështje dhe implementimi. BE-ja dëshiron të shohë progres në këtë pikë.

Në takim u fol edhe për çështjen e Kosovës në të cilën palët ishin të një mendimi për mbrojtjen e minoriteteve serbe në Kosovë.

Në kuadrin e forcimeve të kapaciteteve, Komisioni i Integritetit ka zhvilluar një takim me përfaqësues të Parlamentit Europian, nga Drejtoria e Merrëdhënies me Parlamentet Kombëtare, Z. Alain Barrau dhe Znj. Estelle Carrelet de Loisy.

Të deleguarit nga Parlamentit Europian i kërkuar përfaqësuesve të shprehin nevojat e Komisionit të Integritetit për të përmirësuar punën e tij në kuadrin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit.

Programi i bashkëpunimit dhe i shkëmbimit (COX) është një instrument për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin në marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Parlamentit Europian dhe Parlamentet e Vendeve Anëtare.

Programi zhvillohet në formën e seminareve informative të cilat janë ad hoc në përgjigje të nevojave të Parlamenteve Kombëtare.

Mbi këtë aspekt, përfaqësuesi i Komisionit të Integritetit paraqiti problemet që Shqipëria po përballë me sistemin gjyqësor dhe mbi këtë çështje u theksua nevoja e rritjes së kapaciteteve dhe cilësinë e stafit në lidhje me rolin e Parlamentit për kontrollin e sistemit gjyqësor që për momentin nuk është në gjëndje të japi instrumentat e duhur për këtë mbikqyrje pa ndërhyrë në pavarësinë e pushteteve.

Gjithashtu Komisioni i Integritetit, në nivelin e përfaqësuesve, si dhe në nivelin e stafit, ka nevojë të zgjerojë njohuritë në lidhje me fushat e ndryshme të cilat trajtohen nga MSA, kjo për të mundësuar zbatimin e saj në një kohë sa më të shkurtër, sipas kriterëve të saj.

Një pikënisje për programin u konsiderua çështja e ambjentit e cila është kritike dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me ekonominë, korrupsionin dhe me krimin e organizuar, përtej lidhjeve direkte me nevojat e Shqipërisë ndotjen e ambjentit dhe konservimin e pasurive natyrore.

Programi, gjithashtu do të mundësojë edhe shkëmbimin e eksperiencave mes parlamentarëve, për të përforcuar bashkëpunimin mes tyre.

Mendohet që programi të fillojë në pranverën e vitit të ardhshëm.

Një takim tjetër që Komisioni i Integritetit ka patur, gjatë muajit tetor, ka qënë ai i zhvilluar me Qendrën e Studimeve Parlamentare dhe me përfaqësues të Ambasadës së Britanisë së Madhe në Shqipëri. Takimi u zhvillua në kuadrin e zbatimit të projektit "Rritja e rolit dhe përgjegjshmërisë së Parlamentit shqiptar në procesin e integritetit në BE nëpërmjet veprimtarive legislative me pjesëmarrje të gjërë dhe transparente" i drejtuar nga Qendra e Studimeve Parlamentare dhe i mbeshetur nga Ambasada Britanike në Shqipëri.

Ky projekt përfshin rritjen e kapaciteteve të Komisionit të integritetit në lidhje me ekspertizën ligjore, ndihmën në këtë aspekt nga grupet e pavarura dhe nga ekspertë të huaj. Një synim tjetër i këtij projekti është edhe ndërgjegjësimi nëpërmjet tryezave të rrumbullakëta për diskutime në lidhje me çështjet e procesit të integritetit dhe përafrimin e legjislacionit.

Zbatimi i posaçëm i vlerësimit të ndikimit në procesin e integritit europian dhe procesin e negociatave për praninë

(Botim SIGMA nr.31, maj 2001)

1.1. Hyrje

Vendet që përgatiten për t'u pranuar në Bashkimin Europian ndeshen me detyrën e jashtëzakonshme të transformimit të strukturave të tyre ekonomike, sociale dhe ligjore. Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore po e bëjnë një gjë të tillë në kontekstin e integritit të tyre në Europë, si edhe në kontekstin më të gjerë të qeverisjes sipas stilit perëndimor, globalizimit dhe tregtisë botërore. Ndër këto vende, 10 vendet candidate po ndjekin aktualisht një projekt të gjerë strategjik për arritjen e pranimit në Bashkimin Europian (BE), ndërsa të tjerët kërkojnë të arrijnë statusin e kandidatit. E gjitha kjo vë një barrë mbi qeveritë brenda një kohe relativisht të shkurtër për përpunimin e politikave, përpilimin dhe miratimin e legjislacionit dhe rregulloreve/akteve nënligjore dhe ndërtimin e institucioneve të afta për t'i zbatuar dhe garantuar në mënyrë efikase ato.

Ndërkohë, ekzistojnë një varg detyrash të ndërthurura, të cilat duhen kryer nga qeveritë dhe administratat kombëtare në vendet candidate. Këto detyra përfshijnë:

- Ndjekjen e procesit që nga fillimi i shqyrtimit dhe përgatitja e të gjithë pozicionit negociues në detaje;
- Rishikimin dhe freskimin e Programit Kombëtar për Miratimin e *Acquis* (NPAA) në mënyrë të rregullt;
- Zbatimin e NPAA-së;
- Ndërtimin e institucioneve;
- Programimin e Phare-t dhe llojeve të tjera të asistencës;
- Përgatitjen, programimin dhe zbatimin e Instrumentit për Politikën Strukturore për Para-praninë (ISPA) dhe fondin bujqësor (SAPARD) pas vitit 2000;
- Komunikimin me OJF-të dhe publikun e gjerë;
- Përgatitjen dhe trajnimin e administratës publike për pjesëmarrje në vendim-marrje.

Qëllimi i këtij kapitulli është të tregojë se si teknikat e vlerësimit të ndikimit mund t'u shërbejnë vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore për kryerjen e detyrave që lidhen me integritin europian dhe praninë në BE. Në kontekstin specifik të politikave në integritin europian, qëllimet e vlerësimit të ndikimit shërbejnë kryesisht për t'u siguruar qeverive dhe sektorit privat informacion lidhur me ndikimin politik, ekonomik, social dhe mjedisor të miratimit të politikave të Komunitetit ose të Rregulloreve/akteve nënligjore dhe Direktivave individuale. Idealisht, rezultati do të ishte një vlerësim sasior i kostove neto dhe shpërndarjen e tyre sipas sektorëve të ndryshëm financiarë – buxheti kombëtar, rajonal, dhe buxhetet lokale, sektori privat, konsumatorët e kështu me radhë.

Por edhe kur një informacion i saktë sasior nuk mund të grumbullohet, informacioni cilësor mund të marrë rëndësi të madhe. Për shembull, shpesh ndodh që të jetë e mundur të identifikohen pasojat e një mase për institucionet e brendshme, pa pasur mundësi të specifikohet saktësisht se çfarë kostosh do të shkaktojnë këto ndryshime. Vërtet, në disa raste, analiza cilësore mund të jetë e rëndësishme për të nxjerrë në pah problemet që duhen trajtuar, por të cilat nuk përfshijnë kosto të identifikueshme qartë. Për shembull, roli i institucioneve që merren me kontrollin e kufirit mund të duhet të ndryshohet me praninë në BE dhe administratës drejtuese dhe stafit do t'i duhet kohë për realizimin e këtyre ndryshimeve në mënyrë të tillë që të krijo-

hen sa më pak shqetësime. Një analizë e mirë dhe zbërthim i qartë i ndikimeve të ndryshimeve të propozuara, si sasiore ashtu edhe cilësore, do të ndihmonte në lehtësimin e fazës së tranzicionit dhe do të minimizonte problemet me burimet njerëzore dhe ecurinë e shërbimeve.

1.2. Zbatimi i vlerësimit të ndikimit në praninë në BE

Nganjëherë thuhet se, meqenëse praninë në BE kërkon nga vendet candidate miratimin dhe zbatimin e *acquis communautaire*, vlerësimi i ndikimit është i pakuptimtë, pasi vendi kandidat nuk ka ndonjë zgjidhje tjetër. Kjo nuk është e vërtetë. Ekzistojnë mënyra të ndryshme për arritjen e përshtatjes së kuadrit ligjor të një vendi me kërkesat e BE-së. Arsyeja për këtë ka të bëjë me natyrën e legjislacionit të BE-së, që vjen në dy forma:

- *Rregulloret/aktet nënligjore* duhen zbatuar si një e tërë pa amendime nga vendet anëtare; ato përdoren në ato fusha ku uniformiteti i plotë konsiderohet i nevojshëm për arritjen e qëllimeve të legjislacionit.

- *Direktivat*, në të kundërt, janë shumë më elastike. Ato përbëhen nga "kërkesa të përbashkëta bazë", të cilat duhen përfshirë në legjislacionin e vendeve anëtare. Megjithatë, u lihet në dorë vendeve anëtare që të përcaktojnë mënyrën se si duhet arritur kjo.

Kjo u jep vendeve candidate një shkallë të konsiderueshme elasticiteti në mënyrën se si ato zbatojnë Direktivat e BE-së, dhe këto rrugë të ndryshme të zbatimit mund të kenë ndikime shumë të ndryshme në ekonomi dhe shoqëri. Vlerësimi i ndikimit është vendimtar për përcaktimin e rrugës më të volitshme të zbatimit të Direktivave. Edhe kur zbatimi i një kërkesë i lë pak hapësirë vendit kandidat për manovrim, siç është shpesh rasti me Rregulloret/aktet nënligjore, vlerësimi i ndikimit është sidoqoftë i rëndësishëm sepse përbën një guidë për politikëbërësit lidhur me ndikimin që zbatimi i Rregullores/aktit nënligjor do të ketë në variablet e tjera të politikës. Gjithashtu, analiza e ndikimit të Rregulloreve/akteve nënligjore mund të shërbejë në përcaktimin e përparësive kohore në zbatimin e Rregulloreve/akteve nënligjore të ndryshme, si edhe në planifikimin e buxhetit, në shpjegimin e rregullores/aktit nënligjor për ata që preken prej saj dhe për sigurimin e bashkëpunimit të tyre si dhe në përcaktimin e institucioneve që do të merren me zbatimin.

Në këtë kontekst, duhet shënuar se:

- Proçeset dhe teknikat për kryerjen e vlerësimit të ndikimit janë zakonisht të njëjta si për politikën dhe legjislacionin që lidhen me integritin europian dhe praninë në BE ashtu edhe për të gjitha llojet e tjera të politikave dhe legjislacionit. (Një numër përjashtimesh, dhe konsideratash të posaçme lidhur me këtë do të trajtohen në këtë kapitull.) Çështjet dhe teknikat e diskutuara në Kapitullin 1 mbi përmirësimin e instrumenteve të politikave nëpërmjet vlerësimit të ndikimit, në Kapitullin 2 mbi vlerësimin e ndikimit buxhetor dhe ekonomik të politikave qeveritare dhe në kapitullin 3 mbi konsultimin, vlejnë edhe për praninë në BE, kështu që nuk do të përsëriten në këtë kapitull.

- Vlerësimi i ndikimit nuk zëvendëson procese dhe strategji të tjera gjatë ndjekjes së procesit të integritit dhe pranimit. Qëllimi i tij është të kontribuojë në zhvillimin dhe

(vijon në faqen 11)

Zbatimi i posaçëm i vlerësimit të ndikimit në procesin e integritit europian dhe procesin e negociatave për praninë

(vijon nga faqja 10)

(Botim SIGMA nr.31, maj 2001)

përmirësimin e efektshmërisë së strategjive të tjera, si dhe/ose të ulë kostot dhe efektet anësore negative.

- Kryerja e vlerësimit të ndikimit është në vetvete një kosto sa i përket elementit kohë dhe burimeve njerëzore e buxhetore. Në rastin e pranimit në BE, vendit kandidat i kërkohet të miratojë mijëra pjesë legjislacioni, si edhe shumë politika brenda një periudhe relativisht të shkurtër. Është e pakonceptueshme që një vend të mund të ndërmarrë një analizë serioze të vlerësimit të ndikimit për të gjitha këto ndryshime. Vlerësimi i ndikimit duhet të zbatohet në mënyrë të tillë që të identifikojë fushat kryesore me ndikim në ekonominë kombëtare dhe në shoqëri si dhe ta përqendrojë vlerësimin e ndikimit në këto fusha.

Në përgjithësi, vlerësimi i ndikimit duhet të kryhet vetëm kur përfitimet që burojnë nga procesi i vlerësimit të jenë më të mëdha se sa kostot. Megjithatë, e rëndësishme është të kihet parasysh një koncept i gjerë për "përfitimet e pritshme", dhe jo të shqyrtohen ato vetëm nga pikëpamja e kostove financiare dhe ekonomike. Disa përfitime të tjera si një barazi më e madhe, rritje e shkallës së llogaridhënies, rritja e shkallës së respektimit të ligjit dhe përmirësimi i nivelit të administratës duhen mbajtur parasysh.

1.3. Si mund të kontribuojë vlerësimi i ndikimit për një proces efektiv pranimi në BE

Siç u tha edhe në kapitujt e mëparshëm, vlerësimi i ndikimit është një element në zhvillimin e politikave që synon të përmirësojë informacionin që vihet në dispozicion të politikëbërësve. Në rastin e pranimit në BE, vlerësimi i ndikimit mund t'u shërbejë vendim-marrësve për të optimizuar procesin duke:

- Ndërmjetësuar procesin e përcaktimit të prioriteteve dhe rrjedhës së politikëbërjes si dhe miratimin dhe zbatimin e *acquis communautaire*;

- Siguruar një vlerësim të kostove të mënyrave të ndryshme të zbatimit të politikave ose masave të komunitetit, duke shërbyer kështu si pjesë e evidences për të cilën qeveria ka nevojë në procesin e marrjes së vendimeve politike;

- Sigurimi i informacionit rreth ndikimit që do të sjellin këto masa për publikun dhe sektorin privat në mënyrë që të sigurohet informacion për ndryshimet që duhet të kryhen nëpër institucione, dhe në proceset e menaxhimit dhe prodhimit;

- Matur në mënyrë sasiore ndikimin e masave në buxhetin kombëtar (dhe aty ku është e nevojshme në atë rajonal e lokal) dhe në nevojat financiare të kompanive.

Në rastet kur ka më shumë se një mënyrë për të proceduar duhet bërë një zgjedhje. Kjo ka të bëjë me zgjedhjen e një drejtimi për politikën, një instrumenti, një metode për zbatim dhe garantimin e zbatimit, një kuadër institucional, një strategji negociimi dhe kohën e përshtatshme për të proceduar. Të gjitha këto zgjedhje përfitojnë nga pasja e një informacioni mbi pasojat e mundshme. Është detyrë e vlerësimit të ndikimit që ta sjellë këtë informacion, si sasi-or ashtu edhe cilësor.

1.3.1 Miratimi dhe zbatimi efektiv i *acquis communautaire* nga pikëpamja e kostos

Kjo është fusha më e gjerë dhe më thelbësore në të cilën mund të kontribuojë procesi i vlerësimit të ndikimit. Kostoja e llogaritur për firmat europiane në përgjigje të kërke-

save të BE-së dhe atyre administrative kombëtare shkon në 540 miliardë euro në vit (3-4% e GDP-së). Përveç kësaj, ka kosto buxhetore për nivele të ndryshme të qeverisë. Dështimi në zgjedhjen e rrugës me efektive dhe ekonomike për zbatimin e *acquis communautaire* mund të ulë shkallën e konkurrencës së një vendi në krahasim me anëtarë të tjerë të BE-së. Sigurisht që ka vend dhe arsye për kursime nga ana e individëve, firmave dhe qeverive atëherë kur zbatimi mendohet mirë lidhur me mënyrën si dhe në ç'rend duhet arritur.

Përgatitja për integrimin në BE është një proces kompleks sa i takon minimizimit të kostove. Pavarësisht nga ato që thuhet shpesh, nuk ekziston një mënyrë e vetme për të hyrë në BE, ekzistojnë shumë mënyra. Këto mënyra të ndryshme mund të kenë ndikime shumë të ndryshme në ekonomi dhe shoqëri. Në mënyrë që të përzgjidhet rruga më e mirë drejt integritit në BE, është e nevojshme të kuptohet se cili është ndikimi politik, ekonomik, financiar, ligjor dhe social i miratimit të politikave dhe rregullore/akteve nënligjore të BE-së dhe çfarë mundësish për vendime paraqesin rrugët e ndryshme për zbatimin e vendimeve specifike politike.

Një miratim jo optimal i politikave të BE-së jo vetëm që do të rriste kostot, por edhe do të zvogëlonte përfitimet lidhur me eficienten ekonomike dhe konkurrencen që pritet nga pranimi në BE. Për të ndihmuar në shmangien e këtyre pasojave, duhet kryer vlerësimi i ndikimit për gjetjen e rrugëve që:

- Sigurojnë se zbatimi i qëllimeve sociale të *acquis communautaire* (psh, në fushën e mjedisit) nuk i shkaktajnë kosto të paarsyeshme sektorit privat;

- Ulin koston e sigurimit të shërbimeve publike për të shmangur efektet e kundërta lidhur me taksat si dhe sjellje që shkojnë drejt evitimit të taksave;

- Sigurojnë që kostot dhe vonesat për aktorët ekonomikë që përfitojnë shërbime publike dhe që bashkëpunojnë me administratën (psh, marrja e një licence) nuk do të jetë më e lartë se ç'duhet;

- Mbështeten në bashkëpunimin me vullnet të lirë, që nga përvoja rezulton se është shpesh një rrugë më pak e kush-tueshme për industrinë në procesin e zbatimit të rregullo-re/akteve nënligjore të BE-se nga ç'do të ishte kontrolli administrativ.

Për këto arsye, vlerësimi i ndikimit duhet të jetë, sa më shumë të jetë e mundur, një aspekt i rregullt i procesit të përafritimit ligjor. Ministrinë dhe grupet e punës që përgatisin instrumentet ligjore të vendit për zbatimin e *acquis communautaire*, duhet, aq sa të jetë e mundur, të marrin parasysh gjatë procesit normal të punës së tyre ndikimin që do të kishin qasjet alternative në konvertimin e direktivave në ligje kombëtare, si dhe të identifikojnë kostot dhe përfitimet e të gjithë legjislacionit kryesor të BE-së. Aty ku ka pasoja të rëndësishme, ose ndikime të ndryshme për qasje të ndryshme, çështja duhet ngritur në Këshillin e Ministrave ose në komitetin ministror përkatës për të informuar vendim-marrësit.

1.3.2 Ndërtimi i institucioneve

Rregullimet administrative dhe institucionet që nevojiten për një vend në zbatimin e *acquis communautaire*, në

(vijon në faqen 12)

Zbatimi i posaçëm i vlerësimit të ndikimit në procesin e integritit europian dhe procesin e negociatave për pranim

(vijon nga faqja 11)

(Botim SIGMA nr.31, maj 2001)

pjesën më të madhe nuk rekomandohen nga BE-ja, po lihen në dorë të secilit vendi për t'u përcaktuar dhe zbatuar. Duke qenë se *acquis communautaire* ngre çështje funksionale të cilave u duhet dhënë përgjigje në vend të rekomandimit të zgjidhjeve institucionale për miratim, sfida e kuadrit institucional shndërrohet në gjetjen e realizimit të konformitetit efektiv duke paguar çmimin më të ulët.

Kjo qasje hap një gamë të gjerë opsionesh. Duke pasur parasysh pjesë të ndryshme të *acquis communautaire* është e rëndësishme të shtrohen pyetje të tilla si:

- Legjislacioni i BE-së, a duhet zbatuar duke modifikuar institucionet ekzistuese apo duhet krijuar një institucion i ri?

- Sistemet e zbatimit duhet të jenë publike, private apo të dyja bashkë?

- Si do të kontrollohen brenda dhe jashtë sistemet e zbatimit (publike ose private)?

- Çfarë masash nevojiten për të garantuar transparencë të plotë për formatin institucional që do të krijohet?

Përvoja tregon se anëtarët e BE-së kanë zgjedhur qasje shumë të ndryshme institucionale për zbatimin e pjesëve të *acquis communautaire*. Mësimi i nxjerrë nga vendet anëtare është se barra që bie mbi aktorët ekonomikë formëzohet konsiderueshëm nga mënyra se si *acquis communautaire* ndërthuret me sistemet rregulluese kombëtare dhe nëpërmjet përcaktimit të masave zbatuese dhe garantuese. Ndërtimi i institucioneve administrative për zbatimin e *acquis* ka gjithashtu pasoja të rënda për buxhetin, si në afat të shkurtër ashtu edhe të gjatë.

Në përcaktimin e strategjisë zbatuese, pyetja më e rëndësishme është të vendoset se çfarë duhet optimizuar. Ky vendim duhet marrë në disa fronte. E para, duke qenë se kostoja e përpjekjeve për zbatim mund të fillojë t'i kapërcejë përfitimet në një moment të caktuar, një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar "vlerës relative në lidhje me paranë" gjatë ushtrimit të këtyre strategjive. Së dyti, rregullorja/akti nënligjor administrativ imponon si kosto buxhetore (që paguhen nga taksapaguesit) ashtu edhe kosto ekonomike (që paguhen direkt nga ndërmarrjet dhe që reflektohen në çmime për konsumatorët). Shpesh ndodh një shkëmbim midis këtyre të dyjave. Për shembull, një kompani mund të inventarizohet nga një llogaritar nga sektori privat, i paguar nga firma ose nga një inspektor administrativ i paguar nga taksapaguesit. Mbetet një pyetje e hapur se cili është me efikas nga pikëpamja ekonomike dhe administrative.

Nëse përdorim metodat e diskutuara në tri kapitujt e mëparshëm, vlerësimi i ndikimit mund të jetë një instrument qendror në identifikimin dhe matjen e këtyre pasojave shumë të rëndësishme në kosto dhe efikasitet, qofshin private ose publike, për zgjedhjet alternative të kuadrit institucional.

1.3.3 Përgatitja për negociatë dhe modifikimi i pozicioneve gjatë negociatave

Vlerësimi i ndikimit mund të kontribuojë në përgatitjet që kryen një vend për përpilimin e strategjisë së negociatave duke identifikuar fusha ku vendi mund të kërkojë periudha tranzicioni ose përjashtime, si dhe duke paraqitur të dhënat

empirike (sasiore dhe cilësore) në mbështetje të këtyre argumentave.

Në identifikimin e fushave për periudha tranzicioni është e dobishme të bëhet dallimi midis "rregulloreve/akteve nënligjore të produktit" dhe "rregulloreve/akteve nënligjore të procesit". Rregulloret/aktet nënligjore e produktit kanë të bëjnë me natyrën e produktit në vetvete, për shembull standartet e cilësisë në ushqim, standartet e çlirimit të gazit nga makinat, kërkesat në etiketimin e produkteve etj. Plotësimi i rregulloreve/akteve nënligjore të produkteve është një kërkesë për produktin në mënyrë që ai të tregtohet në BE. Rregulloret/aktet nënligjore të proceseve, nga ana tjetër, kanë të bëjnë me kushtet në të cilat prodhohet një produkt, për shembull standartet shëndetësore dhe ato të sigurisë në punë, ose standartet mjedisore nëpër fabrika. Vendet negociatore duhet të përgatiten që, në momentin e hyrjes në BE, të plotësojnë të gjitha *acquis communautaire* të tregut të brendshëm që kanë të bëjnë me produktet. Mund të jetë vetëm një numër i vogël Direktivash që mund të përbëjë problem: këto duhen hetuar dhe, nëse janë serioze, duhen ngritur si probleme gjatë negociatave. Por këto duhet të jenë argumente krejtësisht teknike, për shembull, që është fizikisht e pamundur, pavarësisht vullnetit maksimal, që Direktiva të zbatohet në kohën e pranimit. Çdo përpjekje këtu për të përdorur përjashtime ose periudha tranzitore për të mbrojtur ndërmarrjet në vend, publike apo private, do t'i komplikonte negociatat dhe ndoshta do t'i zgjaste shumë ato.

Direktivat që kanë të bëjnë me procesin duhet të vlerësohen si duhet nga pikëpamja e ndikimit. Fushat më të rëndësishme janë mjedisi, politika sociale (sidomos shëndeti dhe siguria në punë) dhe ndoshta fusha të tilla si transporti. Aty ku ndikimi i Direktivës është shumë i rëndësishëm dhe sjell probleme të mëdha financiare (ose, në disa raste, një problem institucional), një propozim për një periudhë tranzicioni duhet konsideruar seriozisht.

Natyra e periudhës së tranzicionit që propozohet varet nga natyra e problemit:

- Kur problemi është teknik siç mund të ishte koha e pamjaftueshme për përfundimin e zbatimit të një direktive para pranimit dhe kur miratimi i direktivës është në interes të plotë të vendit negociator, duhet miratuar një afat kohor sa më i shkurtër.

- Kur zbatimi sjell vështirësi të mëdha financiare, mund të shqyrtohen dy mënyra të mundshme tranzicioni:

- Nëse, për rritjen ekonomike dhe stabilitetin makroekonomik është gjithësesi e rëndësishme miratimi i direktivës, duhet negociuar për një periudhë sa më të shkurtër tranzicioni që është e përballueshme financiarisht.

- Në rast se zbatimi i Direktivës nuk është aq i rëndësishëm për rritjen, stabilitetin dhe punësimin në një afat të shkurtër, ose, ndoshta, edhe negativ, periudhat e gjata të tranzicionit janë më të përshtatshme. Një shembull në këtë drejtim do të ishte Direktiva për Ujërat e Zeza Urbane. Në një afat të gjatë, sigurisht që është në të mirë të të gjitha vendeve ta miratojnë atë duke qenë se i shërben konsumatorëve dhe mjedisit. Megjithatë ka një lidhje fare të vogël

(vijon në faqen 13)

Zbatimi i posaçëm i vlerësimit të ndikimit në procesin e integritimit europian dhe procesin e negociatave për pranim

(Botim SIGMA nr.31, maj 2001)

(vijon nga faqja 12)

në afat të shkurtër dhe të mesëm mes Direktivës dhe rritjes ekonomike apo mirëqenies sociale. Do të kishte madje efekt të kundërt: zbatimi do të ishte aq i kushtueshëm saqë financimi i këtij zbatimi do të kishte një efekt ngadalësues në rritjen ekonomike. Në këtë rast vetëm një periudhë e gjatë tranzicioni, ku pjesa më e madhe e zbatimit ndodh në fund të periudhës (kur GDP-ja e vendit është shumë më e lartë) do të ishte zgjidhja ideale.

Një bazë solide argumentimi për periudhat e tranzicionit bazuar në vlerësimin e ndikimit do të ishte objekt i studimeve më bindëse. Gjithashtu, ndërkohë që negociatat përparojnë dhe vendit do t'i duhet të heqë dorë në disa nga kërkesat e veta, informacioni i sjellë nga analiza e ndikimeve do të kontribuojë gjithashtu në marrjen e vendimeve për prioritizimin e pozicioneve me interes kombëtar. Pa një analizë të tillë, do të ishte e pamundur për këshillin e ministrave që të merrte vendime serioze gjatë gjithë procesit të negociatave për ato pozicione që mund të ndryshohen dhe për ato që duhen mbrojtur në mënyrë absolute.

1.3.4 Komunikimi lidhur me integritimin europian

Në pjesën më të madhe të vendeve kandidate të Europës Qendrore dhe Lindore, projekti i pranimit në BE është shumëpopullor, dhe zakonisht gëzon mbështetjen e forcave kryesore politike. Por përvoja tregon se një mbështetje e tillë nuk mund të jetë gjithnjë e tillë kur vendime të vështira merren gjatë negociatave, dhe në një kohë kur disa sektorë mund të vuajnë pasojë negative nga miratimi i kërkesave të BE-së. Për këtë arsye, të gjitha vendet duhet të angazhohen në procesin e komunikimit me publikun për të siguruar mbështetje të vazhdueshme për procesin.

Vlerësimi i ndikimit mund të përmirësojë komunikimin e qeverisë duke dhënë informacion më të gjerë lidhur me atë se si do të përfitojë shoqëria nga vendimet e qeverisë. Në rastet e zgjedhjeve të vështira në procesin e përgatitjes për negociim për pranimin në BE, ndikimi në segmente të ndryshme të shoqërisë është shpesh jo i barabartë, dhe është thuajse e pashmangshme që vendimet, qofshin edhe optimale, të mos ngjallin të paktën një farë kundërshtimi në publik ose sektorë të veçantë. Për shembull, vendosja e një pagese për përdorim për një shërbim që për momentin është falas, është një vendim që gjithnjë shkakton pakënaqësi. Por nëse qeveria nxjerr të dhëna që tregojnë se ky është opsioni më pak i kushtueshëm në një afat të gjatë, ose që është zgjidhja më e drejtë, mund të jetë më e thjeshtë që vendimi të pranohet. Aftësia e qeverisë për të treguar se zgjedhjet bëhen në bazë të analizave solide gjithnjë mund të shërbejë deri në një fare shkalle për marrjen e mbështetjes për vendimet.

Gjatë përgatitjes dhe modifikimit të mëpasshëm të pozicioneve negociuese, transparenca është një politikë e mirë. Sigurisht, presioni i kohës ka prirjen të funksionojë kundër politikës së informimit të elektoratit për pozicionin që qeveria do të mbajë. Por nëse qeveria shikohet si e tillë që merr vendime pa u konsultuar dhe pa e informuar publikun, kjo do të sjellë rënie të mbështetjes për të gjithë procesin e integritimit. Transparenca bëhet edhe më e rëndësishme kur negociatat përparojnë dhe teksa pozicionet kombëtare duhet të modifikohen për të ruajtur vazhdimin e negociatave. Kështu, është një politikë e mirë të ndahen

burime financiare për konsultime, marrëdhënie me publikun dhe informacion që në fillim të procesit të negociatave.

Informacioni solid lidhur me zgjedhjet e një politike dhe një opsioni për zbatim është sidomos i rëndësishëm në marrëdhëniet me parlamentin, i cili si rezultat i procesit të pranimit do të kërkohej të miratojë dispozita në mënyrë që ato të shndërrohen në pjesë integrale të legjislacionit kombëtar. Nuk janë të rralla rastet kur parlamenti kërkon ndryshimin e një ligji ashtu si është propozuar nga qeveria, dhe qeverisë i duhet të ketë argumenta bindës për të siguruar miratimin e këtij legjislacioni.

1.3.5 Anëtarësia efektive

Anëtarësia në BE kërkon nga administrata kombëtare që ajo të marrë pjesë në mënyrë ekstensive në zhvillimin e politikave europiane. Nëpunësit civilë nëpër ministri duhet të jenë në gjendje t'u përgjigjen rregulloreve/akteve nënligjore të reja, si dhe të vlerësojnë, shpesh here brenda një kohe të shkurtër, se cili është ndikimi i këtyre rregulloreve/akteve nënligjore në vendet e tyre. Aftësitë e nevojshme për kryerjen me efikasitet të këtij procesi shpesh përfshijnë të njëjtat aftësi që nevojiten për vlerësimin e ndikimit. Për më tepër, një farë vlerësimi i ndikimit është tani një detyrim për politikëbërësit në BE. Një shembull është Direktiva e BE-së për vlerësimin e ndikimit në fushën e mjedisit, që e detyron publikun dhe sektorin privat të masë pasojat mjedisore të projekteve kryesore të ndërtimit, si ndërtimi i rrugëve ose ndërtimi i komplekseve të reja industriale. Së fundi, kryerja e zgjedhjeve të zgjuara në programimin e fondeve të BE-së kërkon gjithashtu kapacitete për kryerjen e vlerësimit të ndikimit.

Për këto arsye, është e dobishme të mbahet parasysh se investimi i tanishëm për kryerjen e vlerësimit të ndikimit, si dhe në trainimin e nëpunësve civilë për përmirësimin e aftësive të tyre në fushat përkatëse, është një investim në drejtim të rritjes së aftësive analizuuese të ministrave, duke i përgatitur ato kështu për detyra që do t'u caktohen në momentin e anëtarësimit.

1.4 Vlerësimi i ndikimit: Përcaktimi i përparësive

Ndërkohë që vlerësimi i ndikimit mund të jetë në mënyrë të qartë një instrument i dobishëm për pranimin në BE, është gjithashtu e vërtetë se sasia e legjislacionit dhe ndryshimeve në politika që është e nevojshme të kryhet nga vendet e Europës Qendrore dhe Lindore në këtë proces nuk i lejon ato që të kryejnë vlerësime të ndikimit në gjithçka. Duke qenë se burimet janë të kufizuara dhe koha është e shkurtër, është e rëndësishme të përcaktohet se në cilat fusha vetë vlerësimi i ndikimit është efektiv nga pikëpamja e kostos. Parimi bazë është që burimet e investuara në vlerësimin e ndikimit duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e çështjes. Një farë vlerësimi, sado skematik, duhet kryer në secilën pjesë të rëndësishme të legjislacionit të BE-së, ndërsa vlerësimi i detajuar duhet të përqendrohet në subjektet kryesore. Shembujt mund të jenë Rregullore ose Direktiva ku ka potencial për kursime të konsiderueshme ose në ato që njihen se janë problematike për zbatim si edhe fusha të një rëndësie strategjike për negociatat, të tilla si

(vijon në faqen 14)

Zbatimi i posaçëm i vlerësimit të ndikimit në procesin e integritit evropian dhe procesin e negociatave për pranim

(vijon nga faqja 13)

(Botim SIGMA nr.31, maj 2001)

fusha të ngarkuara politikisht dhe fusha potencialisht kandidatë për periudha tranzicioni.

Ekzistojnë të paktën pesë mënyra për të përcaktuar atë pjesë të legjislacionit që një vend do ta vlerësojë në mënyrë më ekstensive:

- Përzgjedhje sipas natyrës dhe kostos së vetë politikës. Ndryshimi midis Direktivave dhe Rregulloreve dhe midis produkteve dhe proceseve u shqyrtua më lart. Direktivat kërkojnë një vlerësim më të gjerë për shkak të elasticitetit më të madh në miratimin e tyre, kështu që ka më shumë opsione për të eksploruar. Rregulloret dhe Direktivat e proceseve janë fusha që kërkojnë më shumë periudha tranzicioni në krahasim me ato që kanë të bëjnë me produktet, kështu që, në kontekstin e përgatitjes së pozicioneve, mund të jenë subjekte më të natyrshme për një vlerësim të plotë apo më të gjerë të ndikimit. Është e rëndësishme të shënojmë se disa nga Direktivat më të rënda nga pikëpamja financiare, fillimisht miratohen me periudha të gjata zbatimi për vendet anëtare, një argument ky që mund të përdoret nga vendet kandidatë për të garantuar periudha të gjata tranzicioni për ato vetë.

Për më tepër, është pikërisht fusha e proceseve ajo që ka volumin më të madh të investimit, publik dhe ndoshta privat. Në fushën e mbuluar nga rregulloret/aktet nënligjore të komunitetit, janë kryesisht rregulloret që kanë të bëjnë me mjedisin dhe me shëndetin e sigurinë në punë që do të kërkojnë investime të mëdha. Niveli total i investimit buxhetor që kërkohet për të zbatuar *acquis* që kanë të bëjnë me proceset e kapërcen në mënyrë të ndjeshme kapacitetet që kanë vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, madje edhe në afat të mesëm. Nëse i shtojmë kësaj edhe investimet në infrastrukturë është e qartë se, megjithë vazhdimin e përqindjeve të larta të rritjes ekonomike, burimeve të planifikuara në planin kombëtar shumëvjeçar të buxhetit dhe të kapacitetit të sektorit financiar për të financuar disa prej investimeve të nevojshme, zbatimi i plotë do të kërkojë disa vjet. Financimi publik ose publik/privat i investimeve sigurisht që ndihmon në përsheptimin e miratimit të *acquis communautaire*, por në Direktiva si ajo që kërkojnë nivele minimale të shërbimit, do të nevojiten financa krejtësisht buxhetore. Duke pasur parasysh koston shumë të lartë që parashikohet për këto direktiva, mundësia për kursim si rezultat i vlerësimit të duhur është gjithashtu e madhe.

- Përzgjedhje sipas përvojës së 15 vendeve anëtare aktuale të BE-së.

Në shumë raste, kandidatët aktualë mund të përdorin përvojën e vendeve anëtare për të identifikuar fushat ku investimi në vlerësimin e ndikimit mund të jetë frytdhënës. Për shembull, Direktivat ku vendet anëtare kanë përdorur menyra shumë të ndryshme për zbatim mund të jenë të vlefshme për t'u eksploruar në mënyrë që të zgjidhet qendrimi më i përshtatshëm për situatën e vendit. Direktivat për të cilat zbatimi ka qene shumë i kushtueshëm dhe ku ka pasur pasoja të rëndësishme të papritura janë gjithashtu fusha kandidatë për vlerësim të plotë të ndikimit. Në të njëjtën kohë kryerja e vlerësimit të ndikimit në këto raste mund të përfitojë nga përvoja e mëparshme, duke i lejuar kandidatët të arrijnë në konkluzione duke shpenzuar më

pak e duke përdorur informacion dhe analiza që ekzistojnë në vendet anëtare.

- Përzgjedhje duke shfrytëzuar përvojën e vendeve të mëparshme kandidatë.

Zgjerimet e mëparshme të BE-së nuk do të thotë se përbëjnë një guidë të mirë lidhur me përcaktimin e problemeve lidhur me pranimin. Zgjerimi i fundit ka qenë me Austrinë, Finlandën dhe Suedinë, por këto vende kishin më pak probleme me përshtatjen e *acquis communautaire* sepse ato ishin anëtare të Marrëveshjes së Zonës Ekonomike Europiane si edhe kishin një nivel rregullues të ngjashëm me atë të BE-së. Pranimi i Spanjës dhe Portugalisë është ndoshta më i rëndësishëm nga pikëpamja e zhvillimit, po këto dy vende u pranuan 15 vjet më parë, përpara se programi i vitit 1992 për përmbushjen e tregut të brendshëm të kishte filluar. Megjithatë është me interes të studiohen nga afër traktatet e pranimit me këto vende të ndryshme dhe të diskutohen problemet e pranimit me zyrtarë që kanë qenë të përfshirë në këto përgatitje.

Për ato vende që filluan negociata me BE-në në shkurt 2000, është e vlefshme të shikohen pozicionet që kanë mbajtur ato vende që i kanë filluar negociatat më 1998. Këto vende i kanë paraqitur të gjitha pozicionet e tyre dhe shumica janë publike. Jo të gjitha këto vende kanë kryer vlerësime të ndikimeve në fushat kryesore të *acquis*, por nëse merren parasyh të gjitha kërkesat për periudha tranzicioni ose masa të tjera që devijojnë nga *acquis*, krijohet një ide e qartë për fushat kryesore që mund të sjellin probleme potenciale.

- Përzgjedhje e bazuar në përvojën e zyrtarëve në ministritë e linjës që janë përfshirë në procesin e seleksionimit. Zyrtarët e ministrive të linjës janë teorikisht ata punonjës të qeverisë që janë më të aftit në identifikimin e fushave problematike. Ata duhet të kenë njohuri të mira të sektorëve me të cilët merren, dhe duhet të dijnë problemet kryesore që i shqetësojnë këta sektorë. Ata duhet të kenë marrë pjesë në shqyrtimin e legjislacionit të BE-së në seancat e përbashkëta me Komisionin Europian në Bruksel.

Një nga problemet kryesore këtu është ndërgjegjësimi i zyrtarëve të ministrive të linjës për llojin e problemeve që mund të shfaqen në fushën e kompetencës së tyre. Autoriteti koordinues në qeveri për integrimin evropian zakonisht është ai që merr rolin e nxitjes së zyrtarëve të ministrisë së linjës në identifikimin e fushave në të cilat duhet përdorur vlerësimi i ndikimit.

- Përzgjedhja nëpërmjet konsultimit me biznesin, sindikatat dhe grupet e interesit në shoqëri.

Disa nga fushat që kërkojnë vlerësim të plotë të ndikimit janë evidente për sektorin jo-qeveritar, por jo për qeverinë. Për këtë arsye biznesi dhe sektorët e tjerë jo-qeveritarë duhet të përfshihen në përcaktimin e fushave për vlerësim të ndikimit. Këto burime jo-qeveritare do të jenë të rëndësishme edhe për përcaktimin e fakteve në vlerësimin e ndikimeve për këto fusha.

PROGRAMI I PUNIMEVE TË KUVENDIT 6 NËNTOR - 28 DHJETOR 2006

1. P/Ligji "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira".
- *Paraqitur nga një grup deputetësh më 24.11.2005*
2. P/Ligji "Për nxitjen e investimeve private në sektorin elektroenergjitikë". (Është shtyrë shqyrtimi më 5.06.2006 për arsye që të shqyrtohet kur të vijë edhe p/ligji nga Qeveria).
- *Paraqitur nga një grup deputetësh të LSI-së, më 26.01.2006*
3. Dekret nr. 4778, datë 16.02.2006 "Për kthimin e ligjit nr. 9467, datë 30.01.2006 "Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 13.12.2005 të Këshillit të Ministrave "Për një shtesë në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", të ndryshuar.
- *Paraqitur më 17.02.2006*
4. P/Ligji "Akti i Lirisë së Shtypit".
- *Paraqitur nga deputeti N. Lesi, më 20.02.2006*
5. P/Ligji "Për një ndryshim të ligjit nr. 7941, datë 31.05.1995 "Për hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 "Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë".
- *Paraqitur nga një grup deputetësh më 9.03.2006*
6. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar.
- *Paraqitur nga deputeti N. Lesi, më 3.04.2006*
7. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
- *Paraqitur nga KM, më 6.06.2006*
8. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në disa ligje organike". (Është diskutuar, por është shtyrë votimi).
- *Paraqitur nga KM, më 20.06.2006*
9. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8607, datë 27.04.2000 "Statusi i Dëshmorit të Atdheut", të ndryshuar.
- *Paraqitur nga KM, më 29.06.2006*
10. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.
- *Paraqitur nga KM, më 4.07.2006*
11. P/Ligji "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".
- *Paraqitur nga KM, më 25.07.2006*
12. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992 "Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror".
- *Paraqitur nga KM, më 3.08.2006*
13. P/Ligji "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë".
- *Paraqitur nga KM, më 6.09.2006*
14. P/Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".
- *Paraqitur nga 20.000 zgjedhës*
15. P/Ligji "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë".
- *Paraqitur nga KM, më 21.09.2006*
16. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar.
- *Paraqitur nga KM, më 25.09.2006*
17. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 9179, datë 29.01.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake".
- *Paraqitur nga KM, më 29.09.2006*
18. P/Ligji "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".
- *Paraqitur nga KM, më 29.09.2006*
19. P/Ligji "Për organizimin, funksionimin, procedurat dhe detyrat e Komitetit Shqiptar të Birësimit".
- *Paraqitur nga KM, më 4.10.2006*
20. P/Ligji "Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimi të INSIG, SHA-së".
- *Paraqitur nga KM, më 10.10.2006*
21. P/Ligji "Për ratifikimin e Planit të Veprimit të Programit Kombëtar 2006-2010, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për popullsinë (UNEPA).
- *Paraqitur nga KM, më 10.10.2006*
22. P/Ligji "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë".
- *Paraqitur nga KM, më 10.10.2006*
23. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë".
- *Paraqitur nga një grup deputetësh më 13.10.2006*
24. P/Ligji "Për Prokurimin Publik".
- *Paraqitur nga KM, më 13.10.2006*

(vijon në faqen 16)

PROGRAMI I PUNIMEVE TË KUVENDIT 6 NËNTOR - 28 DHJETOR 2006

(vijon nga faqja 15)

25. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aktin e Hagës, të marrëveshjes së Hagës, për regjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale, 1960".

- Paraqitur nga KM, më 17.10.2006

26. P/Ligji "Për ratifikimin e Konventës, së Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore".

- Paraqitur nga KM, më 17.10.2006

27. P/Ligji "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi".

- Paraqitur nga KM, më 17.10.2006

28. P/Ligji "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për parandalimin e terrorizmit".

- Paraqitur nga KM, më 17.10.2006

29. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës, të marrëveshjes së Hagës, për regjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale dhe rregulloret mbështetur në aktin e Gjenevës".

- Paraqitur nga KM, më 17.10.2006

30. P/Ligji "Për ratifikimin e Protokollit nr. 13, të Konventës Europiane, për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore, për heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat".

- Paraqitur nga KM, më 17.10.2006

31. P/Ligji "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për parandalimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit".

- Paraqitur nga KM, më 17.10.2006

32. P/Ligji "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007".

- Paraqitur nga KM, më 25.10.2006

33. P/Ligji "Për pastërtinë e figurave të zyrtarëve të lartë të administratës dhe të zgjedhurve".

- Paraqitur nga grupi parlamentar i PD-së, më 25.10.2006

34. P/Ligji "Për verifikimin e të qenit bashkëpunëtor të shërbimeve sekrete shqiptare para datës 31.12.1992, të funksionarëve të lartë publikë".

- Paraqitur nga grupi parlamentar i PS-së, më 26.10.2006

35. P/Ligji "Për kontrollin e figurës së personit zyrtar apo të emëruar në organe të rëndësishme të shtetit".

- Paraqitur nga deputeti Nard Ndoka, më 27.10.2006

36. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa, S.P.A., për financimin e Programit të rehabilitimit të rrugës Shkodër-Hani i Hotit".

- Paraqitur nga KM, më 2.11.2006

37. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Artigiancassa, S.P.A., për financimin e Programit të Rehabilitimit të Portit të Vlorës".

- Paraqitur nga KM, më 2.11.2006

38. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Artigiancassa, S.P.A., për financimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike kombëtare të Tiranës".

- Paraqitur nga KM, më 2.11.2006

39. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9267, datë 29.7.2004 "Për Veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime".

- Paraqitur nga KM, më 2.11.2006

40. P/Vendim "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

- Paraqitur nga KKRT, më 2.11.2006

Bashkëpunëtorë për marrjen e informacionit mbi veprimtarinë e Qeverisë dhe të Kuvendit	Alma Kondakçiu Ditmir Bushati Denis Gila Filip Lako
Stafi i Projektit	Sokol Berberi Denada Breshanaj Milaim Demnushaj

Qendra e Studimeve Parlamentare
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tiranë-Shqipëri Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdpd.org

Collaborators for the information on Government and Assembly activities	Alma Kondakçiu Ditmir Bushati Denis Gila Filip Lako
Project Staff	Sokol Berberi Denada Breshanaj Milaim Demnushaj

Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdpd.org